



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Mr./Faq./Dr./etc. 103

Data/Datum 07.06.2018

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



**Datë: 06.06.2018**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 21, të datës 12.02.2018, paraqitur për shqyrtim nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (a), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.1, nenin 4, nenin 5, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017, mori:

**V E N D I M**

**Për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik**

1. Për themelimin e 'Komitetit për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Fushë-Kosovës', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
  - 1.1 Sabri Rexhepi - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.2 Ilir Hasani - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.3 Fjolla Graiçevci - përfaqësuese e LDK-së, anëtare;
  - 1.4 Durim Hajra - përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.5 Sanije Krasniqi - përfaqësuese e PDK-së, anëtare;
  - 1.6 Ibrahim Xhakolli - përfaqësuese e AAK-së, anëtare;
  - 1.7 Idriz Murtezi - përfaqësues i komuniteteve, anëtar.
2. Komiteti për Zhvillim Ekonomik është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës në fushën e ekonomisë për zhvillimin ekonomik lokal.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Zhvillim Ekonomik, Drejtorisë së ZHE-së dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Br.sir. 104  
Data/Datum. 07.06.2018  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

**Datë: 06.06.2018**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 22, të datës 12.02.2018, paraqitur për shqyrtim nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.2, nenin 4, nenin 6, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017, mori:

**V E N D I M**

**Për themelimin e 'Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit'**

1. Për themelimin e 'Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
  - 1.1 Mirvete Gërguri - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
  - 1.2 Sabit Bullatovci - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.3 Teuta Drenovci - përfaqësuese e LDK-së, anëtare;
  - 1.4 Shpend Bardiqi - përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar;
  - 1.5 Hysen Merovci - përfaqësues i PDK-së, anëtar;
  - 1.6 Shpëtim Gërguri - përfaqësues i AKR-së, anëtar;
  - 1.7 Slobodan Stojković - përfaqësues i komuniteteve, anëtar.
2. Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, në fushën e planifikimit urban dhe rural, kadastrit e gjeodezisë, shërbimeve publike dhe mbrojtjes së mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTORIJA ADMINISTRACIJE

Idetyp/Idetip: 105  
Data/Datum: 07.06.2018  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

**Datë: 06.06.2018**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 23, të datës 12.02.2018, paraqitur për shqyrtim nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.3, nenin 4, nenin 7, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017' mori:

**V E N D I M**

**Për themelimin e 'Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport'**

1. Për themelimin e 'Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport', në përbërje prej shtatë anëtarëve, si vijon:
  - 1.1 Vjollca Konjusha - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
  - 1.2 Arjeta Jashari - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
  - 1.3 Vesel Selimi - përfaqësues i LDK-së, anëtar;
  - 1.4 Qëndresa Bogujevci - përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtare;
  - 1.5 Valon Prebreza - përfaqësues i PDK-së, anëtar;
  - 1.6 Driton Hasolli - përfaqësues i AKR-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.7 Hysni Hasani - përfaqësues i komuniteteve, anëtar.
2. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, në fushën e edukimit dhe arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së KRS dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**


**Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



**Datë: 06.06.2017**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 24, të datës 12.02.2017, paraqitur për shqyrtim nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.4, nenin 4, nenin 8, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017' mori:

**V E N D I M**

**Për themelimin e 'Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale'**

1. Për themelimin e 'Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
  - 1.1 Remzi Shala - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.2 Jetmir Berisha - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.3 Albulena Zeqiri - përfaqësuese e LDK-së, anëtare;
  - 1.4 Eglantina Azemi - përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Komunës, anëtare;
  - 1.5 Ibrahim Berisha - përfaqësues i PDK-së, anëtar;
  - 1.6 Albulena Ibrahim - përfaqësuese i AAK-së, anëtare;
  - 1.7 Bashkim Krasniqi - përfaqësues i komuniteteve, anëtar.
2. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorisë së SHMS dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

|                                                          |
|----------------------------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA                   |
| KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE            |
| Direktorat e Administratës - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU |
| Ref./Ref.istr. 107                                       |
| Data/Datum. 07.06.2018                                   |
| KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE            |



**Datë: 06.06.2018**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 25, të datës 12.02.2018, paraqitur për shqyrtim nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (d), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.5, nenin 4, nenin 9, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017' mori:

**V E N D I M**

**Për themelimin e 'Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim'**

1. Për themelimin e 'Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
  - 1.1 Ali Zogiani - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.2 Miranda Shabani - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
  - 1.3 Ibush Kelmendi - përfaqësues i LDK-së, anëtar;
  - 1.4 Doruntina Jashari - përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Komunës, anëtare;
  - 1.5 Idriz Bajçinca - përfaqësues i PDK-së, anëtar;
  - 1.6 Arianit Ahmeti - përfaqësues i AAK-së, anëtar;
  - 1.7 Fehmi Gashi - përfaqësues i komuniteteve, anëtar.
2. Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, si: tërmetet, zjarret, vërshimet dhe fatkeqësitë industriale dhe teknologjike.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së SHMS dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Stamp of the Municipality of Kosovo-Polje, dated 07.06.2018, with handwritten number 108.

**Datë: 06.06.2018**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 26, të datës 12.02.2017, paraqitur për shqyrtim nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (dh), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.6, nenin 4, nenin 10, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017' mori:

**V E N D I M**

**Për themelimin e 'Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra'**

1. Për themelimin e 'Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
  - 1.1 Albert Jasharaj - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.2 Mirvete Gërguri - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
  - 1.3 Sejdi Sllamniku - përfaqësues i LDK-së, anëtar;
  - 1.4 Durim Hajra - përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.5 Fikrije Gërguri - përfaqësuese e PDK-së, anëtare;
  - 1.6 Jetmir Hasani - përfaqësues i AKR-së, anëtar;
  - 1.7 Sasha Stamenković - përfaqësues i komuniteteve, anëtar.
2. Komiteti për Bujqësi dhe Ujëra është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, në fushën e agrokulturës, rregullimin e sistemeve të ujitjes dhe pendave në lumenjtë e territorit të Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**


**Vjollca Konjusha**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 06.06.2018**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 27, të datës 12.02.2017, paraqitur për shqyrtim nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (dh), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.6, nenin 4, nenin 10, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017' mori:

**V E N D I M**

**Për themelimin e 'Ndërmjetësim'**

1. Për themelimin e 'Komitetit për Ndërmjetësim', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
  - 1.1 Sabit Bullatovci - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.2 Vjollca Konjusha - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
  - 1.3 Ali Zogiani - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.4 Doruntina Jashari - përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Komunës, anëtare;
  - 1.5 Aida Alimi - përfaqësuese e PDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
  - 1.6 Betim Ahmeti - përfaqësues i AAK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
  - 1.7 Qerim Gara - përfaqësues i komuniteteve në Kuvendin e Komunës, anëtar.
2. Komiteti për Ndërmjetësim është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë për palët, të marr vlerësimet e palëve në mosmarrëveshje dhe të jap rekomandime për zgjidhjen dhe evitimin e mosmarrëveshjeve, si dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, në fushën e ndërmjetësimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Ndërmjetësim dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**


**Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.06.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 382, të datës 18.05.2017, paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 25, nenin 27, paragrafi 2, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-mars 2018**

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës, për periudhën janar-mars 2018, në shumë të përgjithshme prej 1,462,172.11€.
2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
  - 2.1 Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 392,134.49€;
  - 2.2 Në arsimin, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 794,408.21€;
  - 2.3 Në shëndetësi dhe Qendrën për Punë Sociale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 267,348.00€;
  - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 8,281.41€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**


**Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.06.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 581, të datës 18.05.2018, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (h), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 7 dhe nenin 27, shkronja (g), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për shpalljen e z. Hajrullah Tërnavës "Qytetar nderi", i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2018**

1. Z. Hajrullah Tërnavë, i lindur me datë 13.04.1952 në fshatin Lismir të Komunës së Fushë-Kosovës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, i diplomuar dhe arsimuar në Akademinë Policore në Kamenicë të Sremit - Novi Sad, Akademinë e Lartë në Beograd dhe Akademinë për Siguri në Shkup, punoi si epror, ligjerues, kryeshef, zëvendësdrejtor dhe drejtor në Akademinë Policore në Vushtrri, komandoi Policinë e Kosovës në kohën e Shpalljes së Republikës së Kosovës në Kaçanik, i mbrojti deputetët e Kuvendit të Kosovës në vitin 1990 dhe kontriboi në formimin e institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës dhe për meritat e tij, në fushën e sigurisë dhe lëvizjes gjithëkombëtare për liri, shpallet "Qytetar nderi", i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2018.
2. Z. Hajrullah Tërnavë, për titullin e dhënë nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës mban të drejtat dhe privilegjet që i takojnë titullit "Qytetar nderi" sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Palës, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 07.06.2018**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 582, të datës 18.05.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (h), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 7 dhe nenin 27, shkronja (g), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për shpalljen e z. Sabit Hykolli "Postmortem qytetar nderi", i Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2018**

1. Z. Sabit Hykolli, i lindur me datë 15.05.1960 në fshatin Kishnarekë të Komunës së Drenasit, i ndjeri shkollën fillore e kreu në fshatin Henc, Gjimnazin në Drenas dhe Akademinë e Arteve - drejtimin për pikturë në Universitetin e Prishtinës, punoi si mësimdhënës në disa shkolla si: shkollën fillore "Bashkimi" në Milloshevë, shkollën e mesme "Nikolla Tesla" në Obiliq, shkollën fillore "Bajram Curri" në Henc, ishte piktor i njohur dhe autor i shumë veprave të artit për personalitete të njohura si: "Babë Sadiku", "Ibrahim Rugova" e "Uiliam Woker", kontriboi për lëvizjen gjithëkombëtare për liri dhe ishte Nënkryetar i Kuvendit të Komunës në dy mandate pas çlirimit, autor i Emblemes së Komunës dhe për meritat e tij, në fushën e artit figurative e sidomos pikturës dhe lëvizjes gjithëkombëtare për liri, shpallet "Postmortem qytetar nderi", i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2018.
2. Z. Sabit Hykolli i ndjeri, për titullin e dhënë nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës familja e tij i mbanë me krenari dhe respekt, privilegjet që i takojnë titullit "Postmortem qytetar nderi" sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Familjes, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**


**Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 11.06.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 260, të datës 25.04.2018, paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për miratimin e “Marrëveshjes për kompensimin e palujtshmërisë” për rregullimin e rrugës dhe trotuarit në Rrugën “Naser Sekiraqa” në Fushë-Kosovë për palën Adem Gjata**

1. Për miratimin e Propozimit Nr. 260, të datës 25.04.2018, për realizimin e “Marrëveshjes për kompensimin e palujtshmërisë” në shumë të përgjithshme të mjeteve financiare prej 22,944.00€, për kompensimin e pronës së marrë nga Komuna e Fushë-Kosovës, në Ngastrën Kadastrale Nr. P - 72514036-00195-5, në sipërfaqe prej  $S = 478m^2$ , në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, për realizimin e interesit publik, rregullimit të rrugës dhe trotuarit në Rrugën “Naser Sekiraqa”, për palën Adem Gjata.
2. Shuma e mjeteve financiare e cekur në pikën një të vendimit është llogaritur në bazë të ekspertizës së vlerësuesit të licencuar Sh.p.k “Box Property”, për një ari në shumë prej 4,800€ dhe konfirmuar me procesverbalin Nr. 15, të datës 25.04.2018, për marrëveshjen e kompensimit ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës dhe palës Adem Gjata.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin dhe lejimin e mjeteve financiare nga pika një e vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit e Pronës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së GJKP, Palës dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

|                                                          |
|----------------------------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA                 |
| KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE            |
| DIREKTORA E ADMINISTRATËS - DIREKTORAT ZA ADMINISTRACIJU |
| Idetja/Idetja: 114                                       |
| Data/Date: 11.06.2018                                    |
| KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE            |



**Datë: 11.06.2018**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 583, të datës 18.05.2018, paraqitur për shqyrtim nga Kryetari i Komunës, mbështetur në kërkesën e banorëve Nr. 02/070/05-0017135/18, të datës 14.05.2018, të shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për rrënimin e objektit të vjetër shkollor në fshatin Miradi e Epërme**

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 583, të datës 18.05.2018, për rrënimin e objektit të vjetër shkollor në fshatin Miradi e Epërme.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Arsimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ARSIMIT, Parashtruesit të kërkesës dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**


**Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 11.06.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 584, të datës 18.05.2018, paraqitur për shqyrtim nga Kryetari i Komunës, mbështetur në kërkesën e banorëve Nr. 02/070/05-0017133/18, të datës 14.05.2018, të shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin në parim, të Propozimit për ndarjen e mjeteve financiare për blerjen e pronës për varreza në fshatin Miradi e Epërme**

1. Për aprovimin në parim, të Propozimit Nr. 584, të datës 18.05.2018, për mbështetjen financiare nga buxheti i komunës deri në shumën 70% të mjeteve financiare, me destinim për realizimin e kërkesës së parashtruar nga banorët e fshatit Miradi e Epërme për sigurimin dhe blerjen e pronës për varreza.
2. Për zbatimin e vendimit dhe lejimin e mjeteve financiare deri në shumën e caktuar, sipas vlerësimeve dhe mundësive buxhetore të komunës për përkrahje të cekur në pikën një të vendimit, Kuvendi i Komunës e delegon kompetencën për vendimarrje te Kryetari i Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen dhe kordinohen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave e Buxhetit, Drejtoria për Shërbime Publike e Mjedis dhe përfaqësuesit e fshatit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Parashtruesit të kërkesës dhe Arkivit.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës


Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 11.06.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 89, të datës 18.05.2018, paraqitur për shqyrtim nga Kryesuesja e Grupit të Grave dhe Zyrtarja për Barazi Gjinore, përmes Kryetarit të Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin në parim, të Propozimit për blerjen e Mamografit në Komunën e Fushë-Kosovës**

1. Për aprovimin në parim, të Propozimit Nr. 89, të datës 18.05.2018, për vendosjen në programet buxhetore gjatë rishikimit të buxhetit për vitin 2018 dhe programet buxhetore për vitin 2019, me destinim që të sigurohen mjetet financiare për blerjen Mamografit, për të ndihmuar gratë e komunës tonë në diagnostifikimin e hershëm të sëmundjeve të kancerit të gjirit.
2. Sigurimi i mjeteve financiare për blerjen e Mamografit, duhet të realizohet nga buxheti i komunës dhe donatorët e mundshëm.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari I Komunës, Drejtoria e Financave e Buxhetit dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS. Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Stamp of the Municipality of Fushë-Kosovë, Kosovo. It includes the text: REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA, KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE, and fields for 'Mënyr/Dati' (117) and 'Data/Datum' (11.06.2018).



Datë: 11.06.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 580, të datës 18.05.2018, paraqitur nga Kordinatorja e Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin në parim, të Projekt-Rregullores për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Komunën e Fushë-Kosovës dhe dërgimin e saj në procedurën e diskutimit publik**

1. Për aprovimin në parim, të Projekt-Rregullores për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes qeverisë komunale për të krijuar një ambient miqësor për fëmijët në Komunën e Fushë-Kosovës dhe dërgimin e saj në procedurën e diskutimit publik.
2. Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Kulturës, Rinisë e Sportit dhe Drejtoritë tjera të Komunës, do të ofrojnë informata e sqarime të nevojshme për opinionin publik lidhur me këtë Projekt-Rregullore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në diskutimin publik.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Kulturës, Rinisë e Sportit, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtoritë tjera të Komunës, Ayra komunale për Komunitete e Kthim dhe Njësi për të Drejtat e Njeriut.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ADM, Drejtorisë së ARSIMIT, Drejtorisë së KRS, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së FB, ZKKK, NJDNJ dhe Arkivit.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës  
Vjollca Konjusha

*[Signature]*





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE  
Nr./No. 118  
Data/Date 12.06.2018  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE



Datë: 12.06.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 387, të datës 18.05.2018, paraqitur nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (d), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin në parim, të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian në Komunën e Fushë-Kosovës 2018-2021 dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik**

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian në Komunën e Fushë-Kosovës 2018-2021 dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik.
2. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në kordinim dhe bashkëveprim me Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoritë tjera të Komunës, do të ofron informata e sqarime të nevojshme për opinionin publik dhe përfaqësuesit e interesuar nga komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptian, në diskutimin publik.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim si bartëse e zbatimit të Planit Lokal të Veprimit për gjithëpërfshirje dhe Drejtoritë e Komunës.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së KRS, ZKKK-së dhe Arkivit.**


**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 12.06.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 387, të datës 18.05.2018, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (k, l, s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (gj, h, n) nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin në parim, të Programit Trevjeçar të Banimit 2018-2021 për Komunën e Fushë-Kosovës dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik**

1. Për aprovimin në parim, të Programit Trevjeçar të Banimit 2018-2021 për Komunën e Fushë-Kosovës dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik.
2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, do të ofron informata e sqarime të nevojshme për opinionin publik lidhur me programin trevjeçar të banimit, në diskutimin publik.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së FB dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës  
Vjollca Konjusha**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 13.06.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të dytë të Propozimit Nr. 34, të datës 08.03.2018, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (c), nenin 17, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 22, nenin 23, të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110 (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 8, nenin 10, të Udhëzimit Administrativ për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifave për rregullimin e Infrastrukturës Nr. 22/2012, nenin 12, paragrafi 12.1 shkronja (ç, nj), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, miratoi këtë

**NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TARIFA NGARKESA DHE  
GJOBA KOMUNALE PËR TAKSAT E NDËRTIMIT PËR VITIN 2018**

1. Miratohet ndryshim-plotësimi i Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 63, të datës 16.05.2013, për caktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin fiskal 2018.
2. Me këtë ndryshim-plotësim të Rregullores shfuqizohet, ndryshim-plotësimi i Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 67, i datës 18.04.2017 dhe caktohet taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin fiskal 2018, për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 17-2/2018, të dates: 23.02.2018, për ndërtimet e kategorisë së parë dhe kategorisë së dytë të objekteve për njësitë e reja të banimit si vijon:
  - 2.1 Taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore për vitin fiskal 2018, është në vlerë prej 2,25€ neto dhe fitohet nga procesi i lëshimit të lejes-pranimi të aplikacionit për lëshimin e fletës poseduese, duke përfshirë zhvillimin dhe azhurnimin e Planit Rregullues Urban.
  - 2.2 Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin fiskal 2018, zbatohet për njësitë e reja të banimit dhe është e ndikuar nga rritja e popullsisë në komunën tonë dhe shërbimet komunale që ofrohen në: arsim, përkujdesje shëndetësore, shërbime publike, mbrojtje e shpëtim, kulturë, rini e sport për kokë banori në komunën tonë, është

fituar vlera prej 172.75€, e cila tarifë në zbërthim i bie të jetë 3,45€ për një m<sup>2</sup>, të sipërfaqes neto.

3. Këto tarifa aplikohen për punët ndërtimore, që rrisin numrin e njësive të reja banuese, shtëpi për vetëm një familje dhe ndërtesa për shumë familje-bloqet e apartamenteve.
4. Llogaritja dhe caktimi i taksës administrative për leje ndërtimore dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë, nga pika dy (2) e këtij ndryshim-plotësimi të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba, do të bëhet nga Drejtoria për Planifikim Urban.
5. Për zbatimin e këtij ndryshim-plotësim të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, është kompetente Drejtoria për Planifikim Urban.
6. Ky ndryshim-plotësim i Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 63, të datës 16.05.2013, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe shfuqizon, ndryshim-plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 67 të datës 18.04.2017.


**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,  
Drejtorisë së PU, Drejtorisë së INSPK dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës  
Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



**Datë: 13.06.2018**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 388, të datës 19.04.2016 dhe plotësimit të Propozimit Nr. 628, të 30.05.2018, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, nenin 61, paragrafi 3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 4, nenin 6, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ Nr. 2014/01 për procedurën e emërimit të Nënkrjetarëve në Komuna, interpretimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-432/2, të datës 25.04.2018, nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, bën këtë:

**NJOFTIM**

**Për pozitën e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës**  
Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën: 31.05.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 388, të datës 19.04.2016 dhe plotësimit të Propozimit Nr. 628, të 30.05.2018, të paraqitur për shqyrtim nga Kryetari i Komunës, pas konsultimeve me komunitetet, propozon për emërimin në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete z. Qerim Gara, përfaqësues i komunitetit ashkali me numrin më të madh të banorëve në Komunën e Fushë-Kosovës, nga radhët e komuniteteve pakicë që jetojnë në komunën tonë, mbështetur në regjistrimin e popullsisë së vitit 2011. Pas shqyrtimit dhe hedhjes në votim të 'Propozimit për emërimin në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete të z. Qerim Gara për mandatin zgjedhor 2017-2021, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës e refuzon përmes votimit të dyfishtë, që parashihet në nenin 61.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale kandidaturën e tij, andaj në aspektin formal dhe juridik propozimi nuk kalon dhe ne nuk mund të marrim vendim.

Kuvendi i Komunës pas refuzimit të propozimit në fjalë, paraqitjes së tij për votim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, duke u mbështetur në ligj, udhëzim dhe interpretimin e nenit 6, paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ Nr. 2014/01 për procedurën e emërimit të Nënkrjetarëve në Komuna, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-432/2, të datës 25.04.2018, ne i drejtohem Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me këtë shkresë zyrtare dhe ju njoftojmë për ecurinë e votimit në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, ky për propozimin në fjalë kanë votuar gjithsej: 22 anëtarë të pranishëm në mbledhje, prej tyre 9 kanë qenë 'për' dhe 4 'kundër' dhe 9 'abstenime', në mesin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që kanë votuar kundër janë përfaqësuesit e komunitetit serb dhe egjiptian z. Ljubisha Qirkoviq dhe Bashkim Krasniqi. Ne kërkojmë nga Ministria e juaj, që të na jepni udhëzime dhe rekomandime të qarta për mënyrën e veprimit në të ardhmen.

Me këtë njoftim informohen: Kryetari i Komunës, i refuzuari për emërim z. Qerim Gara, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkiva.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**  
**Vjollca Konjusha**

